



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
GJIROKASTËR

Nr. Akti 672/77/53 [11232-00682-21-2018]

Nr. Vendimi 49/21-2020-176

Datë rregjistrimi 06.09.2018

Data e vendimit 31.01.2020

Lënda : Dërgimi i shkurtimit të vendimit.

Drejtuar : Qendrës Kombëtare të Bisnesit, Tiranë.

Ekspertes Migena Hana, Tiranë.

Palës ndërgjyqëse, Adrian Çela dhe av. Eno Bushi dhe av. Andrea Zota.

Palës ndërgjyqëse, Albert Kaçi dhe av. Benard Aliko.

SHKURTIM VENDIMI

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër në seancën e datës 31.01.2020, ka përfunduar së gjykuari çëshjen civile me nr. 672/77/53 akti, datë regjistrimi 06.09.2018 me palë ndërgjyqëse dhe objekt:

Paditës :

1. Shoqëria “Petrol Gaz”sh.a, me seli në fshatin Jorgucat, godinë 2 katëshe, Gjirokastër, përfaqësuar nga administratori Adrian Çela, av. Eno Bushi, av. Andrea Zota dhe av. Ester Ruçi.

2. Shoqëria “ Andkri” sh.p.k, me seli në fshatin Jorgucat, godinë 2-katëshe, Gjirokastër, përfaqësuar nga administratori Adrian Çela, av. Eno Bushi, av. Andrea Zota dhe av. Ester Ruçi.



I Paditur:

Albert Kaçi, i biri i Kristos, i datëlindjes 10.03.1967, lindur dhe banues në Gjirokastrë, me adresë: lagja “18 Shtatori”, apartamenti nr. 12, Gjirokastrë, përfaqësuar nga av. Sonila Leci dhe av. Benard Aliko.

Objekti i Padisë:

1. Përrjashtimi i të paditurit nga pjesëmarrja si aksioner në shoqërinë “Petrol Gaz” sh.a
2. Moslikujdimi i kuotës së aksionerit Albert Kaçi nga ana e shoqërisë për shkak të përrjashtimit të tij për shkaqe të arsyeshme.
3. Shkarkimin e të paditurit nga detyra e anëtarit të Keshillit të Administrimit dhe të administratorit të shoqërisë “Petrol Gaz” sh.a.
4. Shpërblimin e dëmit të shkaktuar shoqërisë “Petrol Gaz” sh.a nga veprimet që kanë sjellë përrjashtimin e të paditurit.
5. Detyrimin e të paditurit për pagimin e shpenzimeve gjyqësore, përrfshirë edhe ato të përfaqësimit.
6. Përrjashtimin e të paditurit nga pjesëmarrja si ortak në shoqërinë “Andkri” sh.p.k.
7. Moslikujdimi i kuotës së ortakut Albert Kaçiu nga ana e shoqërisë, për shkak të përrjashtimit të tij për shkaqe të arsyeshme.
8. Shpërblimin e dëmit të shkaktuar shoqërisë “Andkri” sh.p.k nga veprimet që kanë sjellë përrjashtimin e të paditurit.
9. Detyrimin e të paditurit për pagimin e shpenzimeve gjyqësore përrfshirë edhe ato të përfaqësimit.

dhe kundërrpadia me palë dhe objekt si vijon:

Paditës:

1. **Shoqëria “Petrol Gaz”sh.a**, me seli në fshatin Jorgucat, godinë 2 katëshe, Gjirokastrë, përfaqësuar nga administratori Albert Kaçi, dhe av. Benard Aliko dhe av. Sonila Leci.
2. **Shoqëria “Andkri” sh.p.k**, me seli në fshatin Jorgucat, godinë 2-katëshe, Gjirokastrë, përfaqësuar nga administratori Albert Kaçi dhe av. Benard Aliko dhe av. Sonila Leci.

3. **Albert Kaçi**, i biri i Kristos, i datëlindjes 10.03.1967, në cilësinë e aksionerit dhe administratorit të shoqërisë “Petrol Gaz” sh.a dhe të ortakut dhe administratorit të shoqërisë “Andkri” sh.p.k, përfaqësuar nga av Benard Aliko dhe av. Sonila Leci.

I paditur:

Adrian Çela, i biri i Surja, i datëlindjes 25.08.1968, lindur dhe banues në Gjirokastrë, në cilësinë e aksionerit dhe administratorit të shoqërisë “Petrol Gaz” sh.a, si dhe të ortakut dhe aksionerit të shoqërisë “Andkri” sh.p.k, përfaqësuar nga av. Eno Bushi, av. Andrea Zota dhe av. Ester Ruçi.

Objekti i K/Padisë:

1. Përjashtimi i të paditurit Adrian Çela nga pjesëmarrja si aksioner në shoqërinë “Petrol Gaz” sh.a.
2. Moslikujtimi i kuotës së aksionerit Adrian Çela nga ana e shoqërisë “Petrol Gaz” sh.a, për shkak të përjashtimit të tij për shkaqe të arsyeshme.
3. Shkarkimin e të paditurit Adrian Çela nga detyra e anëtarit të Këshillit të Administrimit dhe të administratorit të shoqërisë “Petrol Gaz” sh.a.
4. Shpërblimin e dëmit të shkaktuar shoqërisë “Petrol Gaz” sh.a nga veprimet që kanë sjellë si pasojë përjashtimin e të paditurit.
5. Detyrimin e të paditurit Adrian Çela për pagimin e shpenzimeve gjyqësore dhe ato të përfaqësimit.
6. Përjashtimi i të paditurit Adrian Çela nga pjesëmarrja si ortak në shoqërinë “Andkri” sh.p.k.
7. Moslikujtimi i kuotës së ortakut Adrian Çela nga ana e shoqërisë, për shkak të përjashtimit të tij për shkaqe të arsyeshme.
8. Shpërblimin e dëmit të shkaktuar shoqërisë “Andkri” sh.p.k nga veprimet që kanë sjellë nga veprimet që kanë sjellë përjashtimin e të paditurit.
9. Detyrimin e të paditurit për pagimin e shpenzimeve gjyqësore, përfshirë edhe ato të përfaqësimit.



10. Prishjen e shoqërive “ Petrol Gaz” sh.a dhe “ Andkri” sh.p.k. Likujdimin e tyre. Caktimin e një eksperti likujdator. Rregjistrimin e vendimit në Q.K.R.

Vendimi përfundimtar i Gjykatës është dhënë me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të K.Pr.Civile. Në këto kushte ky vendim gjyqësor do të filloj të ekzekutohet, pavarësisht faktit nëse palët ndërgjyqëse kanë bërë ose jo, ankim në një gjykatë më të lartë, si për themelin e çështjes, ashtu edhe për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm. Ekzekutimi i këtij vendimi mund të pezullohet, vetëm me vendim të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, sipas parashikimit ligjor, të parashikuar në nenet 318 dhe 319 të K.Pr.Civile.

Në lidhje me shpenzimet gjyqësore, ato do të llogariten dhe pasqyrohen në vendimin e arsyetuar të gjykatës dhe nuk do të pasqyrohen në këtë shkurtim vendimi.

Ky vendim i shkurtuar i gjykatës, i njoftohet palëve ndërgjyqëse dhe/ose avokatëve të tyre me nënpunës gjyqësor ose elektronikisht, ekspertes Migena Hana si dhe i dërgohet për ekzekutim Qendrës Kombëtare të Biznesit, Tiranë.

Në vendimin përfundimtar Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, bazuar në ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” si dhe ligjin nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” dhe nenet 306 e vijues të K.Pr.Civile.

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të padisë.
2. Detyrimin e të paditurit Albert Kaçi, t’i paguaj shoqërisë “Andkri” sh.p.k, shumën 737.218 (shtatëqind e tridhjetë e shtatë mijë e dyqind e tetëmbëdhjetë) lekë.
3. Rrëzimin për pjesën tjetër të kërtimeve në padi.
4. Pranimin pjesërisht të kundërpadisë.
5. Detyrimin e të paditurit Adrian Çela, t’i paguaj shoqërisë “Andkri” sh.p.k, shumën 722.495 (shtatëqind e njëzet e dy mijë e katërqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë.

6. Detyrimin e të paditurit Adrian Çela t'i paguaj shoqërisë "Petrol Gaz" sh.a shumën 58.353.197 (pesëdhjetë e tetë milion e treqind e pesëdhjetë e tre mijë e njëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë, si dhe shumën 28.151 (njëzet e tetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e një) Euro.
7. Prishjen e shoqërisë "Petrol Gaz" sh.a dhe të shoqërisë "Andkri" sh.p.k.
8. Kalimin e shoqërisë "Petrol Gaz" sh.a dhe shoqërisë "Andkri" sh.p.k në likuidim, duke emëruar si likuidator, ekspertin kontabël, znj. Migena Hana.
9. Dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm.
10. Urdhërohet Qendra Kombëtare e Biznesit, që pas njoftimit të këtij vendimi të kryejë veprimet përkatëse ligjore, në rregjistrin tregtar.
11. Një kopje e këtij vendimi t'i dërgohet Q.K.B-së, me adresë: Tiranë dhe ekspertit znj. Migena Hana, me adresë: Tiranë.
12. Shpenzimet gjyqësore të llogaritura në tabelen në fund të këtij vendimi, në ngarkim proporcionalisht palëve, në raport me pjesën e pranuar të padisë dhe kundërpadisë.
13. Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar. Kundër vendimit për ekzekutim të përkohshëm të vendimit gjyqësor, mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, brenda 5 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

U shpall në Gjirokastër, më 31.01.2020

SEKRETARE

BURBUQE AJDINI


